

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 2, Datë 27.01.2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALEVE TË MBLEDHJEVE TË DATAVE  
22.12.2021 DHE 29.12.2021 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalet e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjeve të datës 22.12.2021 dhe të datës 29.12.2021, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalet e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 22.12.2021 dhe të datës 29.12.2021 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 29.12.2021

Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z. Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 23

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 23 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z. Sotirag Filo dhe drejtor ekzekutiv

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Ka diçka për rendin e ditës? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika e 2 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIALI "STREHIMIT," SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË".

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazimit, Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I. Nikaj: Programet sociale për strehim janë programe, të cilat shërbejnë për strehi e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofrën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Më specifikisht, programi sociali për strehimin për "Subvencionimin e interesave të kredisë" synon të mbështesë në blerjen e shtëpisë së para, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës. Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, ku prioritet jepet çifteve të reja, individëve me moshë jo më shumë se 35 vjet dhe gra kryefamiljare.

Bazuar në V.K.M nr.453 datë 03.07.2019,"Për masën e subvencionimit të interesave të kredive dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kreditë të shtuar nga shteti", Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka bërë përzgjedhjen e tre bankave që do të menaxhojnë projektin, konkretisht: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo. Familjet aplikante përfitojnë kredi me interes jo më të lartë se 3 % me afat maksimal 30-35 vjet. Nga numri i përgjithshëm i aplikantëve janë përzgjedhur përfaqësuesit e 9 familjeve, për t'u trajtuar nga ky program. Kemi gjithashtu edhe tabelën emërore të punësimit të përcaktuar për çdo përfitues përbërjen familjare, strukturën e apartamentit që përfiton, kushtet e strehimit, kushtet familjare, kushtet sociale, të ardhurat mujore neto të familjes, punësimin dhe vlerën maksimale të apartamentit që përfiton.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Unë kisha një sugjerim fakt, për vitin që vjen çdo muaj nëse ka kërkesa, nëse ka hapësirë brenda programit nuk ka nevojë të presim një listë të gjatë emrash, edhe me pak emra mund t'i diskutojmë, çështjet sociale mund t'i diskutojmë gjithmonë edhe jashtë rradhe. Gjithsesi vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MIRATIM HAPJE DRITE NË PRONË SHETET.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Zhvillimit Hapësinor dhe Infrastrukturës z. I Themeli mund të merrni fjalën.

Këshilltari R.Themeli: Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në pika 2, nëni 9 pika 1.2 dhe 54 si dhe në kërkesën e qytetarit Vangjush Foto për të zhvilluar pronën e tij duke hapur dritë në pronat shtetëse është paraqitur kërkesa në Këshillin e Bashkisë për shqyrtim nga qytetari Vangjush Foto me Nr. 10941 Prot, datë 20.12.2021, si pronar i pasurisë 1/1073, zona kadastrale 8562, L. 1, Rr. "Foqon Postoli", kërkon hapjen e dritës në pjesën lindore të pronës së tij, në drejtim të pasurisë shtetëse me nr. 1/568, e sistemuar nga Ndërmarrja Shërbimeve Publike sipas planvendosjes bashkëngjitur.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Këshilltari J.Deli: Unë kisha një pyetje, kemi patur edhe një rast tjetër para disa muajsh për diskutuar, nëqoftëse Bashkia do të ketë interes në të ardhmen ta zhvillojë si zonë pjesën e shtetit.

do t'i lejohet të ketë hapje drite nga ana e zotërisë, se mesa mbaj mend unë kemi bërë dhe tjetër një shtesë në relacion?

---

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Plani i Përgjithshëm Vendor planifikon ndërtime deri në 3 kate lagjen 1 nuk ka shumë sipërfaqe të gjelbërta dhe ishte e domosdoshme lënia e kësaj hapësi gjelbërt, ligji nuk parashikon asgjë në raste të tilla, duhet diskutuar edhe me pronarin çfarë vendosë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Më parë si ishin këto kërkesat?

Ekzekutivi Zh.Lubonja: Nuk ka patur kaq shumë kërkesa të tilla, plus që flitej më tepër sheshe që ishin prona publike.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ideja është që kjo pronë shtet e ka një destinacion që është luli: nuk është se Bashkia po kërkon të bëjë ndonjë ndërtim aty.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, ka diçka nga këshilltarët për të shtuar? Vazhdojmë votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Pika 4 e rendit të ditës

PËR SHKËMBIMIN E PASURISË NR.4/456, VOL.22 FQ.179 ZK 8561 TRUALL SIPËRFAQE 45M2 NË PRONËSI TË EDMONT ISMET KAMBER DHE JANI ISM KAMBER ME PASURINË NR.4/1252, VOL.57 FQ.247 ZK 8561 TRUALL ME SIPËRFAQE 45M2 NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë z.Gjergji Kristo mund të vazhdoni.

Këshilltari Gj.Kristo: Në materialin e paraqitur flitet për një sipërfaqe në të cilën nevojitet ndërhyrje nga ana e Bashkisë për të rregulluar mënyrën e qarkullimit në atë zonë, ë dakortësuar me bashkëpronarët e saj për shkëmbimin e pasurisë nr. 4/456 me sipërfaqe 45m2

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Në fakt, ky është nga rastet që ne si Këshill mund të themi se i kemi dhënë zgjidhje duke qënë se e kemi pasur një në Këshill dhe nga kundërshtimi ynë, ekzekutivi solli një përpunim të vlefshëm dhe pranueshëm nga të gjithë, ju falenderoj për bashkëpunimin. E hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës

## PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË SHOQËRISË "QENDRA SPORTIVE KORÇË" SH.A

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për pikën 5 të rendit të ditës ju ftoj të kalojmë si Asamblë Aksionerëve për materialin e shoqërisë Qendra Sportive Korçë sh.a. Bordi i shoqërisë paraqitur për miratim buxhetin e qendrës, ju lutem një prezantim të shkurtër nga administrato

Administratori L.Qirinxi: Ne kemi paraqitur materialin për miratim të buxhetit të Qendrave Sportive për vitin 2022, kemi shpjeguar shpenzimet dhe ndryshimet nga viti i kaluar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mund të themi edhe diçka më tepër për publikun jo vetëm gjë relacionit.

Administratori L.Qirinxi: Të ardhurat vjetore të Shoqërisë kapin vlerën e 82,430,797 lekë shpenzimet vjetore kapin vlerën e 82,430,797 lekë. Shpenzimet vjetore të shoqërisë llogaritur në bazë të nevojave për mirëmbajtje të aseteve të shoqërisë, pagave të punonjësve administratës, detyrimet mbi taksat dhe tatimet, mbarëvajtja e aktivitetit sportiv të ekipit zinxhir të Skënderbeut dhe ekipit të parë të Skënderbeut si dhe shpenzime të tjera operative aktivitetet sportive në Bashkinë Korçë për vitin 2022.

Këshilltari E.Tare: Unë kisha diçka për të shtuar, nga disa takime me komunitetin kam dëgjuar që një pjesë e familjeve në nevojë që sjellin fëmijët aty paguajnë 150 lekë të reja, por nëse kanë më tepër se një fëmijë iu shkon pak shtrenjtë për gjendjen e tyre ekonomike.

Administratori L.Qirinxi: Tarifat janë të përcaktuara, të miratuara nga Këshilli Mbikqytar i Qendrës dhe nga Këshilli Bashkiak, megjithatë ne kemi bërë disa ndarje për familjet në nevojë apo ata që kanë probleme me pagesat, i kemi ndarë në kategori ata që ndihmojmë, ata që bëjnë pagesë gjysëm pagesë, ata që janë falas, jemi përpjekur t'i ndihmojmë. Tani nëse është një farë normale dhe do t'i sjellë të tre fëmijët dhe i shkon tarifa 500 lekë unë se di, sugjeroni diçka, mund të veprojmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ideja është që familjet të ndahen në dy grupe, një grup që është në nevojë ekonomike dhe nuk kemi pse t'i privojmë nga përdorimi i Qendrës dhe le të evidentojmë dhe të marrim ulje të ndryshme dhe familjet e tjera që kanë të ardhura një kategori tjetër.

Këshilltore E.Tare: Po flas për familje në nevojë që nuk e vërtetojnë dot gjendjen e tyre, nu dokumentacion siç është për shembull ndihma ekonomike, këtu është problemi.

---

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Epo duhet një vërtetim konkret i këtyre familjeve atëherë, konkret, si mund ta vërtetojë familja gjendjen e saj dhe të bëhet një shtesë në kushtet q Qendra për familjet në nevojë, tani duhet edhe një vërtetim i gjendjes së tyre, se ashtu mur vijnë të gjithë të thonë që jemi në nevojë.

Këshilltore E.Tare: Unë po e shpjegoj që ata janë fëmijë me prindër të cilët nuk janë përfitu ndihmës ekonomike apo nuk janë të regjistruar si punëkërkuar, janë raste konkrete.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po dakort, po një dokument duhet ta kenë ata, qoftë edhe Drejtoria e Kujdesit Social që kjo familje është ndihmuar me pako ushqimore apo diçka tjetër.

Këshilltore E.Tare: Nuk janë një apo dy familje, me listën që kam unë janë diku tek 4 fëmijë, që nuk janë pjesë të ndihmave sociale.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Dakort e identifikojini dhe bëni diçka me Kujdesin Social për t'i pa këta fëmijë me një lloj dokumenti që të mund të përfitojnë më vonë.

Përfaqësues L.Qirinxhi: Tani tek Qendra vijnë plot fëmijë që kanë dëshirë por nuk kanë mur të vijnë dhe ne i kemi marrë në konsideratë dhe iu kemi gjetur një zgjidhje, por nëse ka të që mendojnë se s'mund të vijnë dot dhe nuk vijnë mund të na i thoni ju dhe patjetër që ne konsiderojmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po duhet të jenë diku të evidentuar, ne kemi ndihmuar familje të edhe gjatë pandemisë dhe besoj se i kemi të listuar.

Këshilltore I.Nikaj: Ne kemi diskutuar disa herë për çështjet e Qendrës Sportive dhe mendim në këtë debat është të futet pjesa e abonimeve për fëmijët që bëhen pjesë e kurseve të Qendrës.

Ekzekutivi K.Kita: Janë abonetë, i kemi me ulje.

Administratori L.Qirinxhi: Abonetë që kemi ne janë për fëmijët që frekuentojnë kurs Qendrës, kemi ulje për studentët, por abonime për shfrytëzimin e fushave dhe terrenev Qendrës ne nuk kemi, sepse nuk ka patur ndonjë kërkesë sistematike për të, 600 lekë të v. është ora atje.

Këshilltore I.Nikaj: Unë po flas për familjet në nevojë, që t'iu japim pjesëmarrje në Qendër t atyre.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë padiskutim jam që të paguhet, por për sa shikoj të ardhur janë kaq pak sa edhe po të ishin falas nuk është se do bënin ndonjë ndryshim. Personalisht si se kur ka këto të ardhura kaq të papërfillshme në ditë, mendoj të gjendet një formulë për mbledhur ndonjë lek.

Këshilltari I.Nikaj: Po shumë mirë, qëllimi i saj ky është.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po jo se kështu i bie ta lëshosh fushën vetëm një orë në ditë pak kërkesë ka.

Ekzekutivi K.Kita: Jo nuk është ashtu se fusha e madhe ka gjithë ditën vetëm dy orare të lira.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kontributi i WorldVision ku është këtu se nuk po e shoh materialin?

Administratori L.Qirinxi: Nuk përfshihet WorldVision në material.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po na thoni tani sa është buxheti në total, a jemi partnerë ne na i përmbledhni fondin që ta dimë edhe sa po kontribuojmë ne, shohim gjithë zërat e mundeve energji, ujë, çfarë bëhet me këtë ujë, unë se di tani se janë shifra të konsiderueshme.

Administratori L.Qirinxi: Atëherë Qendra Sportive Korçë paguan fatura energjie dhe fatura për qytezën, terrenin jashtë, gjithë dhomat e zhveshjes dhe për zonën sportive tek stadiumi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Atëherë hapet edhe një tjetër diskutim, për ekipin e Skenderit cili është kontributi ynë në total, se këtu kemi vetëm 35 milion të evidentuar, tani bashkë me kemi bërë një llogaritje që ekipi i Skënderbeut, Bashkisë Korçë dhe taksapaguesve Korçë kushton kaq nga fondet publike? Me këto që thua nuk është vetëm ky 35 milionshi, se si edhe këtu nga shpenzimet operative që keni vendosur kaq sa mund të lexoj në këtë material përmbledhur shumë shkurt. Shikoj që kemi disa grupime shpenzimesh, kemi udhëtim brendshme të ekipeve të futbollit 20 milion, brenda kësaj 35 është ky? Kemi pastaj transport, këto të dyja janë kontribut direkt? Pastaj kemi shpenzimet e tjera që mund t'i takoj prapë ekipit, cilat janë këto shpenzime?

Administratori L.Qirinxi: Po, ja u shpjegoj unë edhe shpenzimet e tjera, do t'ia u çoj edhe detajuar meqënëse në material janë të përmbledhura, në këto shpenzime janë energjia elektrike dhe uji që paguhet për fushën që shfrytëzon akademia, për dhomat e zhveshjes që shfrytëkon akademia dhe çfarë shfrytëkon stadiumi ujë dhe energji elektrike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Sa shkon shuma këtu? Mua më ka ndodhur të më pyesin një po edhe kryetari patjetër besoj se po se çfarë kemi kontribuar ne në këto shuma, se duket se ekipin tani po e mbajmë ne si Bashki kur shikoj këto shifra, çështja është që ta dijë edhe pulsi se ne lexojmë edhe diçka më shumë. Tani i kthehem kësaj tabelës përmbledhëse tek shpenzimet operative 25 milion kë kemi të përfshirë këtu?

Administratori L.Qirinxhi: Po ti referohemi tabelës analitike tek zëri 602 janë të listuara të g ato.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pra këtë shërbim transporti, karburant dhe vaj, çfarë bëni ju këto ku i çoni?

Administratori L.Qirinxhi: E përdorim për ngrohje.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pse janë të vendosura aty këto, ç'lidhje kanë me shërbim transportit? Kemi ndonjë nga financa të na i shpjegojë këtë?

Administratori L.Qirinxhi: Po unë me financën e kam bërë këtë dhe aty përfshihen si zëra, ë kategoria e tillë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Planin e Përgjithshëm Kontabël e ka miratuar qeveria nuk e miratuar unë dhe është publik dhe shpenzimet operative për transport nuk janë kështu, megj it një pyetje bëra nuk ka problem edhe nëse s'ka përgjigje, s'ka të financës këtu mos e zgjasim Pra ky 8 milionshi këtu është vetëm për Qendrën?

Administratori L.Qirinxhi: Po.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ndonjë informacion për kontributin e WorldVision mund të k se di që na u shkurtuan shumë shpenzime nga aty ku ishim?

Administratori L.Qirinxhi: Patjetër, tek materiali që do t'iu dërgoj do i keni edhe këto.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të shtoj unë diçka, kontributi i WolrdVision ndahet në konti financiar dhe kontribut menaxherial. Kontributin financiar do t'ia u dërgojë Luisi ndërsa kontributin menaxherial atë e shohim të gjithë, domethënë nëse atje nuk do të ishte WorldVis si partner unë jam shumë i sigurt që nuk do kishim këto rezultate që kemi sot. Ata meritojnë falenderim për menaxhimin, për punën, për idetë që hidhen atje, për aktivitetet, për menaxh e infrastrukturës. Mjaftojnë të gjitha këto dhe s'ka nevojë për kontributin financiar që ata të në rregull me Bashkinë dhe atë çfarë iu është kërkuar. Patjetër që edhe në aspektin financiar kanë kontribuar, është një pjesë e stafit që paguhet nga WorldVision për menaxhimin e Qen dhe aktivitetet dhe kurset aty dhe shifrat i sjell Luisi, por për mua mjafton pjesa e menaxhim atyre si Kryetar Bashkie t'iu them një faleminderit shumë të madhe që u bënë pjesë e projekti dhe u bënë pjesë e suksesit të asaj Qendre.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit Kryetar që na informove, për këtë informaci kishim fjalën. Tani unë nuk e di çfarë mendojnë këshilltarët e tjerë, por po miratojmë një bu me goxha vlerë dhe besoj se një shpjegim sesi shpenzohen këto para për publikun do ishte sh mirë, e kemi detyrë ta bëjmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po patjetër, publiku duhet ta dijë çfarë ndodh me buxhetin ashtu duhet të dijë mbi pyetjen që ju bëtë se çfarë kontributi ka WorldVision dhe unë si Kry Bashkie përtej pjesës financiare të tyre iu detyrohem një faleminderit nga ana e menaxhim



tyre, sepse shumë herë e bëjmë infrastrukturën dhe dështojmë pastaj në menaxhim dhe përcdo Qyteza dhe Qendra fatmirësisht janë histori suksesi dhe një pjesë të madhe të këtij suksesi fakti i menaxhimit nga ana e WorldVision. Histori dhe bashkëpunime të tilla suksesi t'i kis edhe në raste të tjera kur Bashkia bashkëpunon me organizata.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit, nga këshilltarët ka diçka? E hedhim në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

## 6- KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk kemi kërkesë-ankesa për të diskutuar.

## 7- PIKA TË NDRYSHME.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tani unë kam dy shqetësime për diskutim, e para që e përmendur disa herë është pjesa e trafikut dhe çështja e dytë është prania e qenëve. personalisht jam përdorues mjete dhe nuk është se e vuaj këtë pjesën e kafshëve pa zot, por qytetarët është një shqetësim i përditshëm edhe pse ata janë trajtuar disa herë nga Bas prezenca e tyre është ende shqetësuese. Jo më larg se dje kam patur kontakt direkt nga qytet sot përsëri e njëjta situatë, kërkohet zgjidhje. Tani edhe unë i dua kafshët nuk po them që r dua, por duhet zbatuar ligji dhe ligji thotë se kafsha pa zot, pa origjinë eliminohet.

Ekzekutivi K.Kita: Nuk ka shanse, vrasja e qenit është vepër penale, ndodh vetëm në raste ku sëmundje, kur ka rrezikshmëri të lartë që e përcakton mjeku.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kështu e thotë ligji, ja kam çuar edhe kryetarit, ligji është i q ja po ia u lexoj ndryshimet e ligjit ku neni 9, pika 2 thotë se pas pikes 1, shtohet pika 1.1 me përmbajtje: kafshët pa origjinë, pa pronar dhe kujdestar apo të braktisura nga pronari kujdestari eliminohen dhe asgjeshohen menjëherë në mënyrë të sigurt sipas legjislacionit në shpenzimet për eliminimin dhe asgjësimin përballohet nga buxheti i shtetit.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: I çfarë date është ky ligj?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ja u kam çuar, le ta shikojë dhe Anxhela kur është bërë dhe e mëse i qartë.

Këshilltare I.Nikaj: Unë mendoj se ka një farë frike ndaj çështjeve të mbrojtjes së të drejtat kafshëve, por është problem shqetësues, tani ne edhe i njohim edhe qentë e lagjeve tona, por shkojmë diku në rrugë të panjohur është problem.

Këshilltare G.Koleci: Jo më larg se dje janë paraqitur në spital një grup të rinjsh nga Tirar kishin erdhur për të festuar festat janë sulmuar nga qentë 5 metër larg Bashkisë, janë një qenash që vërtiten gjithë ditën në pedonale dhe tek-trekëndëshi.

Ekzekutivi K.Kita: Nuk janë të njëjtë ata, sepse Bashkia ka 2 vjet që po merret me sterilizim tyre sipas mundësive që kemi me buxhet diku 8-9 milion lekë të vjetra çdo vit dhe duhet të që një qen për t'u sterilizuar kushton 50-60 mijë lek dhe në këtë fushatë sipas ligjit në të g rastet kur qeni shfaq rrezikshmëri apo është me sëmundje ai asgjësohet.

Kryetari i Këshillit S.Filo: Patjetër që është problem, por edhe për eliminimin duhet kujdes, s'mund t'i eliminojmë kështu.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Shikoni ndryshimet e fundit të ligjit dhe vendosni.

Këshilltare I.Nikaj: Unë them se janë dy gjëra, ajo e qenëve endacakë dhe ajo e qenëve me me pronar, duhen disiplinuar edhe këta për pjesën e lëvizjes dhe bërjen e nevojave personale, ciklin e riprodhimit të tyre, se situata ka dalë jashtë kontrollit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kush nuk ka zot është e qartë, duhet bërë një strukturë, d ndarë kush është me zot kush pa zot për një muaj interesohet i zoti nëse del apo jo dhe veng më pas.

Këshilltare I.Nikaj: Një problem tjetër që kam unë janë edhe këto banesat e amortizuar shikojmë në zonën ku banoj unë po edhe në vende të tjera, janë rrezik i shtuar sepse mund të nga momenti në moment dhe mund të shkaktojnë ndonjë tragjedi në momentin që bien.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për banesat e braktisura bëhet fjalë, ato që janë pa njerëz brenda?

Këshilltare I.Nikaj: Po, të braktisura nuk di të them po janë të pabanueshme, nuk ka njeri në t

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani ligji e di unë fillimisht duhet parë nëse kanë rrezik apo jo, d gjendur dhe pyetur edhe pronarët nëse do i shembin ata vet apo jo dhe pastaj duhet ndërhyrë Inspektoriat i Ndërtimit që të bëjë vlerësimin, nuk e di tamam si është ligji për këtë çështje kjo është pak a shumë rruga që duhet ndjekur mesa di unë. Mund të na i jepni edhe adresën : ku është shqetësimi që ju thoni t'i mbajë Zhani shënim dhe ti shohim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka tjetër për të shtuar? Faleminderit për pjesëmarrje uroj vit të mbarë!

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 22.12.2021

~~Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi~~

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes : në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 23

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 23 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtor ekzekutiv

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Pika 1 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika e parë e rendit të ditës, për miratimin e rendit të ditës, ka ndryshime? Dakort, kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KALUAR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Hedhim në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës.

**MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR  
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR,  
PERIUDHËN 1 – 30 NËNTOR 2021.**

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Baraz  
Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj.Irena Nikaj mund të merrni fjalën.

Këshilltare I.Nikaj: Propozohet miratimi i ndihmës ekonomike i përgatitur nga Drejtor  
Kujdesit Social, ku administratori shoqëror ka përzgjedhur duke u mbështetur në bazën ligjor  
familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar  
Fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike është një fond i cili i shtohet çeljes faktike nga listat  
përfituesve të ndihmës ekonomike, të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Për muajin Në  
2021, është në dispozicion fondi prej 181.690 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bl  
ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond përfitojnë 48 familje, të përzgjedh  
sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 108.260 lekë. Po nga ky fond përfit  
kompensim të energjisë elektrike 25 familje, në shumën 31.552 lekë. Pagesa totale nga 6%  
fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji është 139.812 lekë. Të përfit  
ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifike të miratuara  
familje, me fond prej 62.540 lekë. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për  
marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probl  
sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familj  
të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane. Ftoj Kësh  
Bashkiak për miratimin e kësaj pike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës.

**MBI DHËNIEN E SHPËRBLIMIT PËR FAMILJET NË NEVOJË QË TRAJTOHEN  
NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR MUAJIN DHJET  
2021.**

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nevojë për ndonjë shpjegim mbi këtë pikë?

Këshilltari I.Nikaj: Nëse ka ndonjë pyetje nga këshilltarët mund ta bëjnë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, ka diçka nga këshilltarët apo nga ekzekutivi? Kalojmë votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës.

PËR RISHQYRTIM/SHFUQIZIM TË VKB NR. 135, DATË 25.11.2021, "PËR DHËNIE NDIHMËS FINANCIARE Z.DHIMITËR DOLANI DHE ZNJ.VASILIKA DOLANI DËMET E SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E TYRE".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile Rehabilitimit, znj. Edlira Mitre mund të vazhdoni.

Këshilltari E.Mitre: Ne rradhën e kaluar e kemi miratuar këtë pikë, pikërisht në datën 25.11.2021 dhe kjo familje është dëmshpërblyer për shkak të rënies së zjarrit, ku secili nga personat ka marrë një shumë prej 110.000 lekësh. Ky material është futur përsëri në mbledhje për një shtim financiar për shkak të një personi që ka humbur jetën nga rënia e këtij zjarri, fond i cili nuk përcaktohet nga Këshilli as nga vet Bashkia, por nga Ministria, është një material që ka një kontestim idetiv gjithsesi unë kuptoj që duhet lënë në fuqi dhe fondi tjetër pastaj do të miratohet nga Ministria Brendshme.

Këshilltari Gj.Kristo: Për shkak se nga rënia e zjarrit ka mbetur pa jetë një person, shumë dëmshpërblimit duhet të ishte më e madhe, por që kjo shumë nuk varet nga Bashkia, por duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave ose Ministria e Brendshme, pra ne na duhet vetëm ta votojmë për ta lënë në fuqi.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Propozimi është për lënien në fuqi të vendimit të mëparshëm vetëm rishqyrtim nga ana jonë. Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës.

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË NDIHMËS FINANCIARE PËR Z.ROBERT BREGU  
CILIT I ËSHTË DËMTUAR BANESA NGA RËNIA E ZJARRIT.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përsëri Komisioni i Sigurisë Publike, Emergjencave Civile Rehabilitimit, znj. Edlira Mitre mund të vazhdoni.

Këshilltare E.Mitre: Në datën 29.11.2021, në banesën e z.Robert Bregu me adresë fshati Bi Njësia Administrative Bulgarec, Bashkia Korçë, ra zjarr ku pati dëme nga ana ndërtimore orendi shtëpiake. Mbështetur në preventivat e bëra nga Komisioni i Ekspertëve në Këshill Qarkut për dëmet e shkaktuara, në orendi dhe pajisje elektroshtëpiake si dhe dëmet nga ndërtimore, për këtë familje të dëmtuar nga rënia e zjarrit, i propozohet Këshillit të Bashkisë dhënien e ndihmës financiare, për përballimin e disa shpenzimeve emergjente shuma prej 75 lekësh, shumë e cila do të përballohet nga fondi i planifikuar për emergjencat civile të mirat në buxhetin e vitit 2021. Ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës.

PËR PËRDORIMIN E SHITESËS SË FONDIT SIPAS AKTIT NORMATIV NR. 34, DA  
3.12.2021 TË MFE, PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifiki të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, znj. Mamica Nene mund vazhdoni.

Këshilltare M.Nene: Atëherë, në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligj nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 137/20 “Për buxhetin e vitit 2021”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr. 4 datë 25.1.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, si dhe Aktit Normativ nr 34 datë 3.12.20

~~“Për disa ndryshime në ligjin nr. 137/2020 Për buxhetin e vitit 2021, të ndryshuar”, për Bas Korçë është akorduar shtesa e fondit prej 688,568 lekësh. Ky fond është transfertë specifike Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe do të përdoret për shlyerjen e detyrimit prapambetura, duke u nisur nga detyrimi më i vjetër i papaguar, sipas nenit 7 të këtij akti.~~

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? E hedhim në votim. Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË I INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, znj. Mamica Nene munc vazhdoni.

Këshilltare M.Nene: Në mbledhjen e Komisionit dje ne shqyrtuam relacionin, i cili mendojmi ishte shpjeguar në mënyrë të hollësishme dhe ndarja e pagave ishte korrekte. Megjithatë në fillim të mbledhjes së sotme pati një diskutim nga anëtarët e Këshillit, mund ta shpjegoni vet, z. L. ju e morët fjalën në fillim të mbledhjes mund të vazhdoni.

Këshilltari S.Laze: Janë disa paga që çdojnë mbi pagën minimale tek shërbimi i kopshteve e çerdheve ku ka ende punonjës që paguhen me pagë minimale madje edhe më pak dhe unë i një konkretisht, ja u shpjegova dhe para fillimit të mbledhjes ndarjen edhe sipas mbajtjes sigurimeve para dhe pas vendosjes së ligjit të ri të pagave.

Ekzekutivi A.Dishnica: Niveli i pagave 280 mijë lek është paga e funksionit jo paga minimale dhe nëqoftëse i mbledh me pagën e diplomës del më lart se paga minimale në rang vendi.

Këshilltar S.Laze: Mund ta verifikoni në shërbimin e çerdheve që edukatorja merr më pak pastruesja pa dashur ta prek pastruesen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Anxhela po flasim për punonjës shërbimi.

Ekzekutivi A.Dishnica: Punonjëset sanitare janë me pagë fikse, nuk e di pse të rezulton ty a ato janë të detajuara në klasa.

---

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Do ta sqarojmë deri në fund të mbledhjes, ka diskutime të për momentin? Do e hedhim në votim besoj, vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës.

### MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2022 TË BASHKISË KORÇË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Materiali në vijim i përket Komisionit të Financës, por meqë bëhet fjalë për miratimin e buxhetit ja japim fillimisht fjalën Kryetarit të Bashkisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mbledhja e sotme është shumë e rëndësishme pasi do të miratohet një prej dokumenteve më të rëndësishme të funksionimit të Bashkisë, siç është Buxheti i Bashkisë për vitin 2022. Unë do të bëj një prezantim të shkurtër të materialit duke u ndaluar në shifrat që kanë interesin më të madh për të treguar se çfarë synojmë ne apo cilat janë prioritetet tona për vitin që vjen dhe që synojmë ti realizojmë me anë të këtij buxheti. Sa i takon buxhetin totali i tij kap një vlerë prej 1,889,325 mijë lekë. Në pjesën e të ardhurave parashikohet një shtesë prej 175 milion lekësh të reja, tek transferta e pakushtëzuar me 10 milion lek të reja, transferta e pakushtëzuar sektoriale me 70 milion lekësh të reja, të dyja transfertat janë në rritje që tregojnë pikëpamjen time është një tregues i mbështetjes që qeveria qendrore u jep Bashkive të pushtetit lokal. Investimet parashikohen në vlerën 195 milion lek të reja, pra edhe investimet parashikohen në rritje, ndërkohë shpenzimet kryesore që parashikohen janë ato për paga dhe shpenzime të sigurime shoqërore, ato pësojnë një ulje nga viti i kaluar, shpenzime operative ngelen në një nivel. Mendoj se me këto shifra të përgjithshme që kemi me buxhetin e vitit 2022 tejkalojmë përfundimisht situatën e vështirë të krijuar nga pandemia, nga e cila kemi filluar të dalim që nga viti 2021 dhe ku në vitin 2022 përfundimisht kthehemi në trendin normal zhvillimit të Bashkisë dhe shpresojmë që edhe nga ana shëndetësore të mbyllet kjo situatë për vitin që vjen. Për sa u takon drejtimeve kryesore të punës sonë për vitin që vjen fillojmë të investojmë në infrastrukturën. Infrastruktura do vazhdojë të jetë shumë e rëndësishme për ne dhe do të jetë prioritet për punën e Bashkisë në të gjithë sektorët, duke filluar nga infrastruktura rrugore kemi lënë një fond në buxhetin e investimeve rreth 70 milion lekësh të reja, i cili do të përdoret për të financuar apo bashkëfinancuar projekte në infrastrukturën rrugore si në qytet ashtu edhe në zonat rurale. Ne synojmë të vazhdojmë edhe bashkëpunimin me Fondin Shqiptar të Zhvillimit



në vitin që po lemë pas mbyllëm disa bashkëpunime si në Drenovë dhe Boboshticë, pra në rurale. Tani kemi paraqitur përsëri disa projekte tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit për pje qytetit, kemi prioritet lagjen e re, tek ish-fusha e druve, ndërkohë që do vazhdojmë ndërhyr zonat informale, ku në listën e rrugëve që kemi dërguar tek Fondi i Zhvillimit janë një rrugësh që lidhin fshatrat me akset nacionale të Korçës dhe investime në rrugë brenda fshat. Aktualisht do të përmbyllim në vitin 2022 investimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit segmentin nga ura e Turanit e më tej, i cili do t'iu shërbejë disa fshatrave si Porodinës, Vin dhe Dajmanecit. Siç e theksova ne kemi paraqitur një listë me segmente të ndryshme br zonave rurale që janë prioritet për vitin që vjen. Përveç infrastrukturës rrugore, prioritet i y të jetë pjesa e ujësjellësave dhe kanalizimeve kryesisht ato në zonat rurale, pasi brenda q kemi vetëm disa problematika të vogla në zonat informale ndërkohë që pjesa tjetër e qytetit i e furnizuar 24 orë me ujë. Me pjesën e ujësjellësave kemi bërë një përparim shumë të ma vitet e fundit pasi fal bashkëpunimit me projektet IPA dhe në bashkëpunim me Këshil Qarkut si dhe me financime të qeverisë shqiptare kemi ndërhyrë në 17 fshatra me punin pjesëshme apo edhe ndërtim të plotë të rrjetit të ujësjellësit. Pjesë e këtyre projekteve do të edhe dy ndërhyrje rrugore përfundimtare në Barç dhe në Voskop, do të asfaltohen dy segm qendrore. Ndërhyrje e rëndësishme do të realizohet edhe në ndriçimin publik, ne k nënshkruar marrëveshje me qeverinë zviceriane për një projekt për ndriçimin në vlerën e milion lekësh të reja si në qytet ashtu edhe në zonat rurale dhe besoj se me realizimin e projekti ne përmbyllim pjesën e ndriçimit në çdo fshat të Bashkisë së Korçës. Në pjesë shërbimeve, buxheti i Bashkisë synon të mbështesë ato shërbime që Bashkia e Korçës ofron qytetarëve të saj dhe në zonën urbane dhe në atë rurale. Po e filloj me shërbimin e pastrimit, i është një prej shërbimeve kryesore që ne ofrojmë me një buxhet të konsiderueshëm, por që e ju e dini është caktuar edhe si një prej pritoriteteve kryesore edhe nga ana e qeverisë qendr Ky buxhet për vitin 2022 parashikon një fond prej 120 milion lekësh të reja për pastrimin, i do të financojë kontratën që ne kemi me kompaninë e pastrimit të qytetit si dhe grumbulli dhe transportin e mbetjeve edhe për qytetin e Korçës edhe për zonat rurale. Në shifrën që theksova me lart nuk janë përmendur apo nuk janë llogaritur buxheti që përdor NSHP-ja pastrimin në qytetin e Korçës të sipërfaqeve të gjelbërta si dhe blloqet e pallateve që janë jas kontratës me kontraktorin privat si dhe buxheti i NSHP-së që harxhon në zonën rurale. Shërbi gjithashtu të rëndësishme janë shërbimi i gjelbërimit, i ndriçimit në qytet dhe në fshat, transp që zë një pjesë të konsiderueshme në buxhet siç ju e dini që jemi e vetmja Bashki që ofroj shërbim falas për moshën e tretë. Një grup i rëndësishëm, shumë i rëndësishëm do thoja i brenda buxhetit të Bashkisë është buxheti dedikuar çështjeve sociale për mbështetjet kategorive në nevojë. Kjo pjesë e buxhetit për 2022 synon të mbështesë disa projekte të kujdes social, duke filluar nga strehimi, do të vazhdojmë projektet që i kemi patur edhe në vite mëparshme, unë po i përmend shkurtimisht siç janë përmirësimi i kushteve të strehimit, ku i këtë zë kemi vendosur një buxhet prej 10 milion lekësh të reja dhe në vitet e kaluara sëbash edhe me Ministrinë e Financave e cila bashkëfinancon ne ndërhymë në banesat të cilat bano nga familje në nevojë dhe për vitin 2022 mendojmë ta zgjerojmë numrin e përfituesve. Do

vazhdojmë mbështetjen për bonusin e strehimit, për subvencionimin e kredive si dhe jetë diskutime me Entin Kombëtar të Banesave për të realizuar ndërtimin e banesave me kosto të Buxheti i Bashkisë do të vazhdojë mbështetjen për qendrat që ne kemi për personat e moshë të tretë, kemi 4 qendra dhe do të vazhdojmë t'i mbështesim edhe në vitin e ardhshëm bashkëpunim edhe me Këshillin e Qarkut. Mbështetje do të kemi gjithashtu për strehëzën familjet që gjenden në kushtet e dhunës në familje, mbështetje për fëmijët në familjet në rrezik me anë të disa projekteve. Mendoj se zhvillimi më i madh në fushën e shërbimeve sociale është jetë projekti që ne kemi për krijimin e një qendre të shërbimeve të kujdesit social që do të jetë ku kanë qënë zyrat e rajonit nr.2 dhe do të jetë një qendër ku do të përfshihen disa objekte dhe synojmë të kemi një qendër model edhe nga ana e infrastrukturës dhe nga ana e organizimit ofrimit të shërbimeve. Jemi një nga dy Bashkitë pilot në Shqipëri sëbashku me Bashkinë e Vlorës ku do të implementohet edhe ngritja e një strukture të re të ofrimit të këtyre shërbimeve dhe qëllimi është që këto shërbime të shkojnë më pranë familjeve dhe të kenë mundësinë të një identifikim më të mirë të rasteve përpara se ato të kthehen në raste apo situata emergjente. Arsimit do të jetë gjithashtu një prej sektoreve prioritarë, përse i takon infrastrukturës arsimore. Për godinave të kopshteve dhe çerdheve apo shkollave ne kemi parashikuar një buxhet që kryesisht mirëmbajtjes së përgjithshme që ne kryejmë çdo vit për këto objekte kemi parashikuar edhe një fond prej 30 milion lekësh të reja me të cilat synojmë të hyjmë në bashkëfinansim me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për pjesën e arsimit që menaxhohet nga Ministria e Arsimit dhe të kemi mundësinë të realizojmë disa rikonstruksione të objekteve arsimore. Në buxhetin e arsimit kemi parashikuar edhe një rritje të fondit dedikuar për ngrohjen e objekteve shkollore, ka qënë një shqetësimeve që kemi pasur edhe në dëgjesat që kemi bërë me drejtuesit e shkollave kështu kemi parashikuar që periudhën e ngrohjes ta zgjatim me një muaj, pra nga 15 nëntori deri në mars që ka qënë deri tani ta bëjmë 1 nëntor deri në 30 mars. Përse i takon artit dhe kulturës buxheti do vazhdojë të bëjë një mbështetje shumë të madhe për të tre institucionet e artit dhe kulturës. Buxheti është në rritje krahasuar me vitin e kaluar, pasi në vitet që lamë pas kemi parashikuar kufizime për shkak të pandemisë, ndërkohë që për vitin 2022 kemi bërë një kalendar të planifikimit të aktiviteteve, sepse arti dhe kultura janë shumë të rëndësishëm për një qytet si Korça pasi është një qytet që ka një traditë shumë të madhe në art dhe në kulturë, traditë në nivel kombëtar dhe tjetra është që ne aktivitetet kulturore dhe artistike nuk i shohim thjesht si aktivitete gjallërimin e jetës kulturore, por edhe si aktivitete që synohen të frekuentohen nga vizitorët që popullojnë qytetin tonë. Për sa i takon sportit, parashikohet një rritje gjithashtu të buxhetit të sportit, është një rritje besoj e justifikuar pasi kemi disa lloj sportesh të zhvilluara ku këtë vit mbështetjes priten rezultate edhe më të mira për të rikthyer traditën e kampionëve të qytetit tonë. Ne jemi një nga të paktët qytete që organizojmë një kampionat shumë të mirë voleybolli me ekipet amatore, pjesë e së cilës bëhen edhe profesionistët duke bërë kështu një tërheqje të të rinjve dhe fëmijëve drejt sportit. Sa i takon zhvillimit ekonomik, shumë i rëndësishëm prandaj e lashë edhe për në fund, pasi është një prej prioriteteve të punës së Bashkisë duke u lidhur drejtpërdrejt me mirëqënien dhe zhvillimin e familjeve të Bashkisë sonë. Do të veçoja 3 sektorë si më të rëndësishmit, turizmi ku mbështetja e Bashkisë do të vazhdojë të jetë edhe gjatë këtij viti që vijon.

Përveç investimeve në infrastrukturë, ne kemi realizuar paketën e festave, shumë e rëndësishme për të gjallëruar jetën në qytet si dhe kalendari i aktiviteteve të tjera artistike dhe kulturore. Gjitha këto unë besoj se do të vazhdojnë të përbëjnë një paketë atraktive dhe Korça vazhdojë të mbetet në top listën e destinacioneve shqiptare për t'u frekuentuar si destinac turistike. Ka ende gjëra për t'u përmirësuar dhe besoj se edhe struktura që kemi ngritur zhvillimin e turizimit do të luaj rolin e saj. Bujqësia do të vazhdojë të ketë një vëmend veçantë nga ana jonë. Një pjesë e madhe e buxhetit të NSHP-së i dedikohet projektev mbështetje të fermerit dhe bujqësisë dhe këtu kam parasysh projektet për kanalet kulluese, rri e parcelave dhe projekti i fundit, më i rëndësishmi e kam përmendur disa herë është projek synon ta kthejë Korçën në një qendër të rëndësishme të zhvillimit të teknologjisë informacionit, një projekt i cili do të ketë një impakt të madh në punësimin e të rinjve pa që nevojshme që ata të largohen nga qyteti. Teknologjia krijon mundësinë e tejkalimit të barrië të qyteteve të vogla, kemi zhvillime shumë të mira në këtë drejtim dhe synojmë që në mu pare të vitit që vjen të përmbyllim nga ana e infrastrukturës hubin e teknologjisë, informaci artit dhe kulturës ku krahas bibliotekës së re që është bërë tani më funksionale do të përfun edhe godina tjetër tek ish-prefektura dhe shpresoj shumë që në muajt e parë të vitit që vjen i kemi mundësinë të prezantojmë edhe kompaninë e parë që do t'i hapim derën e bashkëpur në Korçë. Duam që në drejtim të teknologjisë, komunikimit dhe informacionit ne t'i japim kë kompanive një paketë të plotë, t'iu japim stafin e kualifikuar, ambjentet e përshtatshme pastaj edhe paketa fiskale si ato që kemi paraqitur në miratimin e saj. Shenjat janë premtuese unë shpresoj që në një hark kohor të shkurtër ne do të kemi mundësinë të prezantojmë mode para të suksesit në këtë drejtim. Këto janë ato që unë kisha menduar t'i veçoja për t'i para shkurtimisht përpara jush, ndërkohë nga ana e shifrave nëse kërkohen të dhëna të tjera mur përgjigjet Drejtorja e Financës. Ju ftoj të gjithëve ta miratojmë buxhetin e Bashkisë Korçë vitin 2022 për t'i hapur rrugën gjithë projekteve dhe shërbimeve të parashikuara.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit, nga Komisioni i Financës ka diçka për të shtuar?

Këshilltare M.Nene: Kryetari bëri një paraqitje të hollësishme të të gjithë buxhetit dhe duke materializuar është punuar me seriozitet në të mirë të shërbimeve publike që ofron Bashkia. Ajo bie në sy është edhe marrja parasysh e kërkesave që kanë dalë nga dëgjuesat publike siç është i barazisë gjinore apo edhe dhënia e çmimit "Gruaja e Vitit". Në këndvështrimin tim programi janë të përcaktuara qartë dhe ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Këshilltare I.Nikaj: Vlerësojmë se buxheti i Bashkisë është paraqitur në mënyrë të detajuar c treguar edhe shifra mjaft pozitive për vitin që vjen rrjedhimisht edhe një gjendje financiar rritje të Bashkisë. Bashkia ka parashikuar nevojat sociale të komuniteteve të ndryshme njëkohësisht një vlerësim i madh shkon edhe për marrjen parasysh të sugjerimeve dhe kërkes që ne kemi bërë. Në pjesën më të madhe të parashikimeve kemi një ndarje në përqindje

burrave dhe grave. Vlerësoj krijimin e një tradite që ka treguar ndaj programeve të reja, siç është titulli "Gruaja e Vitit" që përcakton edhe njëherë vlerat e shumë përfaqësuesve që në këto shumë fusha të jetës, gra të fuqishme dhe të zhvilluara. Shoh me shumë interes edhe përfshirjen e grupeve të marxhinalizuara, por sidomos programet e dhunës, të cilat kanë nevojë për përsëritje edhe pse në rritje dhe përmirësim nga gjendja ku kemi qënë. Shprehem pro këtij buxheti dhe uroj suksese.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka ndonjë pyetje, diskutim nga këshilltarët e tjerë?

Këshilltare E.Menkshi: Unë nuk ndalem shumë tek shifrat, këtë e shpjegoi shumë mirë znj.N. që është edhe e fushës, unë vlerësoj paraqitjen, por më çedon pak pjesa e parë e materialit duket që me financierë Bashkia është shumë mire, po jo me gjeografët, sepse që në faqen e theksohet fjala rrethi, rrethi, rrethi ndërkohë që jemi në termat e Bashkisë. Edhe vjet kam fjalë për këtë gjë, mua me vjen keq që nuk është dëgjuar, por megjithatë profesionalizmi ma lejojë të përsëri në dukje që të jetë një material i pastër që firmoset nga disa persona.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po, vërejtja është e drejtë.

Këshilltare E.Menkshi: Kryetar mos ma merrni negativisht, thjesht mua më bie në sy që në faqen e parë ky gabim, se për pjesën tjetër absolutisht nuk kam asgjë, programet në të dimë, zhvillimet qytetit edhe në kohë pandemie gjithashtu e dimë, qyteti është tërheqës fal edhe ndërhyrjeve organizimeve tuaja, unë të gjitha këto i vlerësoj pafund, por thjesht nga ana estetike më vjen syrin.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Faleminderit për komentet. Ka diçka tjetër për të shtuar? Unë ndalesha pak në disa pyetje në fakt, ne kemi diskutuar edhe herë të tjera për atë që quhet diversifikimi i të ardhurave, ndërkohë një çështje tjetër është edhe dhënia që ne kemi bërë llogaritje pas here për hapësira publike në përdorim, mbase ka erdhur momenti t'i shqyrtojmë pak thellë këto materiale që na vijnë dhe të kuptojmë si po përdoren këto prona. Ka pasur rritje të suksesi sigurisht siç është Terminali apo Parku Tregëtar, por nuk e dimë ç'bëhet me këto prona të tjera që mund të kenë qënë toka bujqësore apo çfarë tjetër mund të kenë qënë se i mbaj mend fragmentarizuar dhe unë mendoj se në kushtet që ne duam të rrisim shërbimet duhet të rritet buxheti. Ju folët edhe për pjesën e punësimit me anë të zhvillimit të qendrës së teknologjisë, duhet të mendojmë edhe për ata që nuk merren me teknologji. Gjithashtu doja të vlerësoja theksoja faktin e marrjes parasysh dhe përfshirjes në buxhet të disa çështjeve që u ngritën dolën nga konsultimet publike që u zhvilluan me qytetarët dhe pati një reagim të shpejtë i tyre, kjo vlen për t'u përgëzuar, por përsëri ka çështje që unë i kam diskutuar shumë herë dhe vazhdoj t'i diskutoj siç është ajo e ngarkesës së trafikut në rrugë, menaxhimi i qarkullimit mendimin tim kërkon një vëmendje të veçantë, një plan të detajuar, një investim që mund të jepte zgjidhje këtij problemi, sepse kam përshtypje që do na i dëmtojë edhe tregun e turizmit nëse nuk i jepet zgjidhje. Një shqetësim tjetër që dua të evidentoj, megjithëse edhe këtë e kam

përmendur kohët e fundit është krijimi i një borxhi të prapambetur i qytetarëve ndaj Bashkimit të Kosovës që nuk janë paguar në kohë dhe që tani pas një kohe të gjatë janë bërë një shuazim papërballeshme nga ana e qytetarëve, nuk e di nga ana ligjore nëse mund të ketë ndonjë zgjidhje për ta? Shumë prej tyre ndoshta duhet të ishin njoftuar edhe në kohë, sepse mund të kishin detyrime të grumbulluara prej 10 vitesh që tani bien pak rëndë për t'u paguar njëherësh mund të jenë familje me probleme ekonomike përderisa nuk kanë patur mundësi të paguajnë në kohë këto detyrime. Pra, duhet menduar edhe si do të merren këto të ardhura, sepse edhe tjetër nuk mund të miratojmë ndryshime të tilla duke qënë vit elektoral dhe do shtyhen edhe vite të tjera këto çështje. Sigurisht që ka shumë gjëra për të vlerësuar, po dihet që sado miqsi duam më shumë, gjithnjë e më shumë mundësi për qytetin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo është njerëzore normalisht, gjithmonë do kërkohet për më shumë dhe shumë mirë që ekziston kjo gjë. Sa i takon pyetjes për asetet publike të Bashkisë menaxhimi i tyre është një çështje shumë e rëndësishme, tani varet si ishte pyetja, aspekte të ndryshme të gjenerimit të të ardhurave, në këtë drejtim në dijeninë time sa kërkesa kemi patur bizneset për t'u marrë asetet publike të Bashkisë për t'i përdorur për një projekt të caktuar biznesi në këto qënë dashamirës, nuk kemi refuzuar, kjo edhe në të mirë të marrëdhënies që krijohet mes biznesit dhe bizneseve. Ajo që ne po bëjmë është përmirësimi i listës së aseteve publike, kemi bërë rregjistrim të aseteve në kuadrin e një projekti në vitin 2008-2009 po që kanë pasur pasaktësira dhe po i rishikojmë me një staf topografësh që ta kemi të qartë dhe të përcaktuar listën e aseteve të Bashkisë në dispozicion të projekteve të ndryshme. Kemi pak vështirësi pjesën e tokave bujqësore, për shkak se ato janë përcaktuar me VKM që i kanë pasur komunitet dhe kjo krijon probleme nëse kërkohet tokë në Boboshticë apo diku tjetër është pak komplikuar kjo situatë ndërsa për pjesën tjetër të aseteve jemi mirë, akoma më mirë do ishin kishim më tepër, por përgjigjemi për këto që kemi për t'i licencuar. Për sa i takon plan menaxhimit të trafikut, dakort është i rëndësishëm, përpiqemi të realizojmë një plan, po problematikat që lidhen me trafikun, qarkullimi, parkimet, pikat e rrezikshme e të tjera nuk është se i zgjidh plani. Duhet një plan strategjik që pastaj të kuptohet ku duhen investimet, megjithatë nuk mendoj se situata është aq emergjente, por përsëri ka një pjesë në planin rregullues që merret me trafikun edhe pse jo shumë i hollësishëm. E drejta është se kjo duhet të ishte bërë brenda planit rregullues, por për shkak të afatit të shkurtër që u bë plani, mbase nuk pati kohë që të punohej me shumë kujdes dhe me detaje në çdo komponent të tij. Rradha e punës është që duhet të bëjë një studim mbi zhvillimin demografik, zhvillimin ekonomik, zhvillimin e trafikut, atë bujqësisë dhe pastaj këto do reflektoheshin brenda planit rregullues, por megjithatë edhe në moment që jemi, edhe në kushtet që jemi mund të proçedojmë me një studim më të përgjithshëm mbi këtë gjë. Për sa i takon pjesës së taksave dhe tarifave, ajo është një çështje ligjore, nuk çfarë thotë ligji për këtë gjë pasi këto faljet bëhen me akte të qeverisë, me vendime të qeverisë nuk di të them një përgjigje konkrete për këtë gjë. Soni kemi ndonjë shifër të nxjerrë sa i takon këto?

Ekzekutivi S.Prifti: Problemi është se unë kam folur edhe me Bashkitë e tjera dhe asnjë B. nuk e merr të drejtën t'i falë këto detyrime, tani nuk e di si funksionon nga ana ligjore.

---

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani kjo falja është dhe pak problematike se hap debat për ata që qënë të rregullt që në një moment të dytë edhe ata të mos paguajnë, sepse shohin që mund të një falje pas disa viteve. Nuk e di kemi apo s'kemi të drejtë nga ana ligjore për të bërë këtë por që ha debat kjo çështje.

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo gjithmonë parashikohet dhe vlen falja, për tarifat për shembull mund të ndikohet.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nëse nuk ka diçka për të shtuar nga këshilltarët kalojmë në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës.

**MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2025 PËRFUNDIMTAR.**

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo pike është për miratimin përfundimtar apo jo?

Këshilltare A.Verushi: Po kryetar i kemi kaluar të gjitha fazat, tani jemi në fazën e fundit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka nga ekzekutivi apo Komisioni për të shtuar? Kalojmë votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës.

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2022-2025 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2023 BASHKIA KORÇË.**

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare, znj.Mamica Nene mund të marrin fjalën.

Këshilltare M.Nene: Relacioni është i përshkruar në mënyrë të hollësishëm duke përfshirë gjithë etapat e programit buxhetor që ne kemi miratuar dhe cilat do të jenë rezultatet që prej tij. Ju ftoj ta miratojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një pyetje kisha unë, ky kalendar miratohet vetëm nga ju?

Ekzekutivi V.Ziko: Janë të gjitha etapa të përcaktuara dhe miratuara edhe më parë, ky është thjesht miratimi përfundimtar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nëse nuk ka gjë për të shtuar kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 12 e rendit të ditës.

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 136, DATË 25.11.2021 " PËR MIRATIMIN BURSIVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Materialet janë shpërndarë siç theksohen edhe në rendin e ditës ndërkohë Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes, znj. Edlira mund të vazhdoni.

Këshilltare E.Mitre: Në fakt bëhet fjalë për një material që ne e miratuam në mbledhjen e kaluar emrat e nxënësve që kanë përfituar bursë, por këtë herë kemi një shtesë me disa emra të cilat janë shpërndarë për të gjithë ne, ju ftoj ta miratojmë edhe këtë ndryshim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 28

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 13 e rendit të ditës.

~~PËR MIRATIMIN E VAZHDIMIT TË PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR PËR SIPËRFAQEN PYJORE, E CILA DO T'JU NËNSHTROHET PROCEDURAVE HEQJES NGA FONDI PYJOR.~~

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika në vijim e rendit të ditës flet për miratimin e vazhdim të procedurave të heqjes nga fondi pyjor për sipërfaqen pyjore, e cila do t'ju nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor. Këto titujt gjithmonë pak të çuditshëm pa fillim dh mbarim, megjithatë Johan meqënëse je këtu, ku çfarë sipërfaqeje bëhet fjalë?

Ekzekutivi J.Marko: Pjesa e gurores që kishim do të hiqet nga fondi pyjor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Çfarë do ndodhë me guroren do shtohet, do zgjerohet?

Ekzekutivi J.Marko: Ishte një sipërfaqe 1.1 hektarë dhe është marrë edhe një shtesë tjetë shkon diku tek 6 hektarë dhe aplikohet për t'u hequr nga fondi pyjor.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Një pyetje kam unë, çfarë qeraje paguajnë këta?

Ekzekutivi J.Marko: Nuk paguajnë qera ata.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po mirë të gjejmë një formulë të marrim si Bashki disa të ardh

Ekzekutivi J.Marko: Kjo varet nga shfrytëzimi i sipërfaqes dhe nuk përcaktohet nga ne.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nejse, mund të vazhdojë Komisioni me fjalën e tij.

Këshilltari Gj.Kristo: Subjekti "TANUSHA" shpk ka aplikuar pranë Ministrisë së Turizmit Mjedisit për heqje nga fondi pyjor të sipërfaqes prej 2.6 ha, e cila mbështetur në pikë shkronja ç, të VKM nr 591, datë 09.10.2018 Për disa ndryshime në Vendimin nr 1353, 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërke mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurav zvogëlimit të sipërfaqes e vëllimit të fondit pyjor" të ndryshuar, me anë të së cilës kërkon he nga fondi kullësor të një sipërfaqe pyjore prej 2.6 ha të ndodhur në ekonominë pyjore Zëmt Qarr në ngastrën nr 178b, Njësia Administrative Mollaj. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i ë drejtuar Bashkisë Korçë me shkresën Nr 7968/3 Prot, datë 09.12.2021, ku kërkon nga Sekt Pyjeve, përgatitjen e Raportit tekniko-ekonomik për këtë sipërfaqe dhe shprehjen e dakortë nga ana e Këshillit Bashkiak për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor i sipërf prej 2.6 ha që do të shërbeje për kryerjen e aktivitetit minerar për shfrytëzimin e mine gëlqeror nga shoqëria "TANUSHA" shpk.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Mirë mos e lexo gjithë materialin të lutem, diçka specifike.



Këshilltari Gj.Kristo: Po këto ishin nuk ka diçka specifike.

~~Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, tani unë kisha një diskutim meqënëse edhe nga një v që kemi patur nga një bashki tjetër ajo e Skraparit u bë pyetja si veprohet në rastin e guror sepse ata merrnin diçka nga këto.~~

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do ketë qenë fjala për rentën minerare.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Jo nuk ishte renta minerare ishte diçka tjetër. Anxhela ishte ed atë ditë, pate ndonjë kërkim për këtë çështje?

Ekzekutivi A.Dishnica: Jo.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ata bënë një pyetje se si veproni ju me këtë rast, me idenë që tani ata e kishin aplikuar diçka të tillë dhe e shpjeguan si vepronin edhe në bazë të hektarëve kjo mund të jetë një mundësi që mund të gjenerojmë disa të ardhura. Ata na pyetën ne ndë me logjikën se mos duhet të paguhet më shumë, ndërkohë që ne ju thamë se tek ne nuk aplik kjo lloj gjeje e kemi pa tarifë. Edhe diçka tjetër, paguajnë taksë këta?

Ekzekutivi A.Dishnica: Tarifë jo taksë, nuk ka taksë me ligj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort tarifë ç'rëndësi ka.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Cfarë tarife? Tani tarifa është kur kryhet një shërbim, çfarë shër kryhet në këtë rast?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Taksë mbi pronën për shembull.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Prit tani, kemi taksat dhe tarifat, taksat janë të përcaktuara me ligj

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ligji kur e ka parashikuar këtë e keni parë taksën? Se ka taksë tokën bujqesore, ka taksë dhe për truallin, po për pyllin që e kemi në shfrytëzim s'paska taksë

Ekzekutivi S.Prifti: Nuk ka taksë as për pyllin as për kullotat.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po mirë mund ta shikoni këtë mundësi se vendimet online. Nuk e kam për vete se nuk kam as pyje as kullota, po mund të jetë një mundësi për të mbledh të ardhura. Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

---

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Me sa vota miratohet kjo pikë?

Ekzekutivi A.Dishnica: Nuk është se ka një pikë ku thuhet kompetenca juaj për të miratuar si kjo.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Cila pikë e nenit pra shkruhet, të lutem Këshilli Bash kompetencat i ka të përcaktuara.

Ekzekutivi A.Dishnica: Kjo përfshihet më tepër në një ligj të posaçëm të Këshillit të Ministrave

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Cila pikë e nenit pra se po debatojme kot për një çështje, k jemi referuar? Se këtë diskutim e kemi bere edhe njëherë.

Ekzekutivi A.Dishnica: Neni 54.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përvec 54, cila pikë? Ne kompetencat i kemi të qarta, ka një për këtë pune, cila pikë, cila gjermë përkatëse a, b, c, d cila?

Këshilltare I.Nikaj: E lexuar bazueshmërinë ligjore në material?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Unë u votua, do ta zbardh, do ta firmos, por paraprakisht du më sqaroni cilës pike i është referuar, për ndryshe do t'i kërkoj mendim Prefektit meqenës nuk e sqaroni dot.

Pika 14 e rendit të ditës.

#### INFORMACION PËR NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË AKTIVEVE INSTITUCIONEVE ARSIMORE (KOPSHTË DHE ÇERDHE).

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kjo pikë është një informacion për nxjerrjen jashtë përdorim aktiveve të institucioneve arsimore, znj.Monda mund të vazhdoni.

Përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse R.Pikuli: Ne kemi përgatitur informacionin për të gjithë kopshtet dhe çerdhet, të cilat kanë mbushur afatin e përdorimit dhe janë në momentin që du nxjerrë jashtë përdorimit. Informacioni është shumë i detajuar, janë nxjerrë të gjitha me si besoj se e keni parë. Komisioni i vlerësimit i krijuar dhe ai me urdhër të titullarit të Ndërmarrjeve vlerësoi gjëndjen e materialeve dhe përcaktoi arsyet për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve siç janë: aktivet kanë plotësuar kohën e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit; ripa është i pamundur si pasojë e konsumit; kishin humbur cilësitë e tyre të përcaktuara në kushte teknike dhe ishin dëmtuar rëndë nga lagështia. Për këto arsye komisionet e vlerësimit të ngri pranë çdo njësie përcaktuan se këto aktive nuk janë në gjëndje pune dhe nuk mund të përdoren.

apo transferohen në njësi të tjera. Për këto arsye këto aktive do të nxirren jashtë përdorimit dhe informuar për këtë procedurë dhe Këshillin Bashkiak.

---

Pika 15 e rendit të ditës.

#### KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.

Sekretare E.Naçi: Nuk ka kërkesë-ankesa për këtë muaj.

Pika 16 e rendit të ditës.

#### PIKA TË NDRYSHME.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të lutem Spartak meqënëse e hape si diskutim pak më çështjen e pagave, si qëndronte shqetësimi?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ja le të na i shpjegojë znj.Rajmonda më mire.

Përfaqësuese Rajmonda: Ne pagat i kemi të trashëguara nga Drejtoria Arsimore dhe paga kopshitet dhe çerdhet në komuna ndryshonin nga ato në qytet.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk po flasim për diferencë mes edukatoreve, po flasim për rritje minimale, ky ishte shqetësimi.

Ekzekutivi V.Ziko: Kjo situatë duhet sqaruar në vend jo në Këshill, sepse varet për çfarë rreth bëhet fjalë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të jetë edhe në bazë të orëve, sepse ne kemi edhe policë sanitare me kohë të pjeshme, Spartaku thotë jo është me kohë të plotë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po s'mund të jetë tani edukatore me kohë të pjeshme, sa i rreth fëmijët 4 orë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Nuk e di tani, prandaj duhet parë nga afër kjo çështje, s'mund të diskutojmë këtu.


Këshilltare I.Nikaj: Kryetar unë doja të bëja një propozim, me sa kemi mundësi si pjesëta këtij Këshilli të bëjmë disa pako dhurata për familjet në nevojë, sipas mundësive të bëjmë kontakt të mirë për komunitetin, kush të dëshirojë do ngelemi në kontakt.

Këshilltare E.Menkshi: Shumë iniciativë e mirë profesore, unë personalisht e kam individuale këtë iniciativë nga shpërblimi që marrim një shumë të caktuar për një familje megjithatë edhe nëse ju mblidhni një shumë të caktuar edhe aty bashkohem pa problem.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për shkak të ngeljes jashtë të disa materialeve për këtë mbledhje të fundit ditën e mërkurë në datë 29.12 për t'i përmbyllur gjithë materialet këtë vit, do të jetë mbledhje e shkurtër, ju ftoj të jeni pjesë e saj, për sot ju falenderoj pjesëmarrjen!

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI

ERJON NEXHIPI

